

Emërtimi dhe Forma Ligjore

Ujësjiellësi Berat-Kuçovë

Shoqëri aksionare

NIPTI

J62903166T

Adresa e Selisë

Ish Kombinati i Tekstileve

Pas Degës së Doganës, BERAT

Data e krijimit

17.07.2000

Nr. i Rregjistrimit Tregtar

24148

Veprimtaria kryesore

*Prodhimi dhe furnizimi me ujë të
pijshëm dhe largimi i ujrave të
ndotura.*

PASQYRAT FINANCIARE

VITI 2017

Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2017 deri 31.12.2017

DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE 31.03.2018

PASQYRAT FINANCIARE JANE INDIVIDUALE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE SHPREHURA NE LEKE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE RRUMBULLAKOSURA NE 0 LEKE

TABELA E PËRMBAJTJES

A. RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR	
B. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI).....	2-3
AKTIVI	2
DETYRIME DHE KAPITALI.....	3
C. PASQYRA E PERFORMANCES	4-5
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	4
PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE	5
D. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE.....	6
E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO.....	7
F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	8-18

Dhimo Dundo

Adresa: Lagjja "Iliria" Rr."Antipatrea", Ndërtesë 2
katëshe pas Bashkisë së re, Berat
Liçenca profesionale,Nr.8, datë 11. 01.2000
Cel:069 20 99 203,
Tel/fax: (032) 238360,
E-mail: dhimo_dundo@hotmail.com

ALB-AUDIT sh.p.k

Adresa: Rr. EMIN DURAKU,Nd.2, H. 6, Ap. 10
Nj.Administrative Nr.5, K. Postare 1019, Tiranë
Tel/fax +35542251744
Cel : 0692042251
Email.albaudit@gmail.com :hsulaj@yahoo.com

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare "Ujësjellësi Berat-Kuçovë" sh.a.

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "Ujësjellësi Berat-Kuçovë" sh.a, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të).

Baza për opinionin me rezervë

- Pasqyra e pozicionit financiar të shoqërisë përmban llogari të arkëtueshme neto nga aktiviteti i shfrytëzimit në shumën 427,720,266 lekë. Ashtu siç është paraqitur në shënimin nr.6 të pasqyrave financiare shoqëria ka kryer një çmuarje për zhvlerësimin e tyre. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjes së përdorur për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit e për rrjedhojë ne nuk jemi në gjëndje të përcaktojmë saktësinë e masës së këtij rregullimi për gjëndjet në fund të vitit 2017.
- Sikurse është paraqitur në shënimin nr.6 të pasqyrave financiare në kërkesa "Të tjera debitoare" shoqëria ka paraqitur kërkesa për tu sqaruar në shumën 20,171,088 lekë që janë shërbime konsulence të kryera në kuadrin e zbatimit të

marrëveshjes së kredisë me Kreditantalt für Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW) për projektin "Furnizimi me Ujë Shqipëria e Mesme" Komponenti Berat Kuçovë. Sipas shoqërisë shuma prej 151,719,35 Euro ose 20,171,088 lekë janë shërbime konsulence që i përkasin edhe shoqërive të Ujësjellës Kanalizimeve Lushnje e Pogradec. Duke qënë se, megjithse kanë kaluar disa vjet, ky pretendim ende nuk është zgjidhur ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse kjo shumë do të vazhdojë të jetë si kërkesë për tu sqaruar apo do të kalojë në shtesë të vlerës së akteve të krijuara nga zbatimi i marrëveshjes së huasë projekti "Furnizimi me Ujë Shqipëria e Mesme" Komponenti Berat Kuçovë e për rrjedhojë të efekteve që mund të kishte në vlerën e amortizimit dhe rezultatit financiar të shoqërisë.

- Në shënimin nr.6 të pasqyrave financiare, "Të tjera të arkëtueshme", ka kërkesa debitoare të vjetra që u përkasin llogarive "Personeli" dhe "Debitorë të tjerë" në shumën gjithsej 9,314,023 lekë për të cilat drejtimi i shoqërisë nuk ka një evidencë objektive të vlerësimit të tyre dhe nuk ka njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Nga auditimi rezulton se ka faktorë të rëndësishëm për zhvlerësim të cilat duhet të analizohen individualisht sipas nivelit të riskut, për saktësinë dhe mundësinë e arkëtimit të tyre.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Çështje për t'u theksuar

- Në zbatim të programit "Infrastruktura Bashkiake II" shoqëria ka realizuar projektin e investimit "Rehabilitimi i rrjetit të Ujësjellës Berat dhe Kuçovë" i cili përveçse është një investim i ri, ka zëvendësuar dhe një pjesë të madhe të rrjetit ekzistues. Po ashtu, ne proces vazhdon të jete edhe investimi për instalimin dhe vënien në funksionim të sistemit të matësve elektronik Wirls. Siç është përshkruar në shënimin nr.9 të pasqyrave financiare, në bazë të vlerësimeve të drejtimit, këto investime janë njohur si aktive afatgjata dhe janë paraqitur një pjesë si investime në proces dhe pjesa tjetër si aktive afatgjata në shfrytëzim dhe të amortizueshme. Pjesët e aktiveve të zëvendësuar nuk janë çregjistruar dhe për to ka vazhduar llogaritja e amortizimit.

Në përputhje me SKK-5 "Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale", amortizimi i një aktivi afatgjatë material fillon kur aktivi është i gatshëm për përdorim, kur ai është në vëndin dhe kushtet e nevojshme që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Ne vlerësojmë se pavarësisht nga argumentet që përdor drejtimi ka faktor domethënës që ato duhet të merren si aktive afatëgjata të amortizueshme.

Njëkohësisht me njohjen e tyre si aktive afatgjata të amortizueshme duhet të çregjistrohen dhe vlerat kontabël neto të pjesëve të aktiveve që zëvendësohen, duke patur parasysh identifikimin dhe vlerësimin e shumave të rikuperueshme që mund të përfitohen nga nxjerrja e tyre jashtë përdorimit.

- Vazhdon të jetë ende pa u përfunduar procesi i regjistrimit në Z.R.P.P-të të disa prej pronave të paluajtëshme të shoqërisë. Sipas informacioneve të marra nga drejtimi procesi ka ecur ngadalë, për pasojë, sasitë dhe vlerat që ato kanë aktualisht në kontabilitetin e shoqërisë nuk mund të konsiderohen të plota.

Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë çdo informacion financiar ose jo-financiar që jepet në raportin vjetor që mund të publikohet si një dokument i vetëm ose një kombinim i dokumenteve, por që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne, nga informacionet që kemi siguruar para datës së raportit të audituesit, nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në shtojcën bashkangjitur raportit. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

ALB AUDIT sh.p.k

Hetem Sulaj - Auditues Ligjor



Berat, më 23 Maj 2018

AUDITUES LIGJOR

Dhimo Dundo



Shtojcë e Raportit të Audituesit

Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
A	AKTIVI			
I	Aktive Afatshkurtëra			
1	Mjete Monetare	5	14,621,620	10,414,949
2	Investime(Tituj Pronësie të Njësive Brënda Grupit,Aksion		-	-
3	Të Drejta të Arkëtueshme:	6		
	1.Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit (Klientë)		427,720,266	396,289,121
	2.Njesitë Ekonomike Brenda Grupit		-	-
	3.Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike		-	-
	4.Të Tjera (Debitore të tjerë)		47,096,339	57,486,069
	5.Kapital i Nënshkuar i Papaguar		-	-
	Totali i të Drejtave të Arkëtueshme (1-5)		474,816,605	453,775,190
4	Inventarët:	7		
	1. Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		40,546,157	31,752,886
	2. Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte		-	-
	3. Produkte të Gatshme		-	-
	4. Mallra		-	-
	5. Aktive Biologjike		-	-
	6. AAM të Mbajtura për Shitje		-	-
	7. Parapagime për Inventar		-	-
	Totali i Inventarit(1-7)		40,546,157	31,752,886
5	Shpenzime të Shtyra	8	41,394,120	42,981,433
6	Të Arkëtueshme nga të Ardhurat e Konstatuara		-	-
	Totali i Aktiveve Afatshkurtër (I)		571,378,503	538,924,458
II	Aktive Afatgjata			
1	Aktive Financiare:			
	1.Tituj Pronësie në Njesi Ekonomike Brenda Grupit		-	-
	2.Tituj Huadhënieje në Njesi Ekonomike Brenda Brenda Grupit		-	-
	3.Tituj Pronësie në Njesi Ekonomike Pjesëmarrje		-	-
	4.Tituj Huadhënieje në Njesi Ekonomike Pjesëmarrjeje		-	-
	5.Tituj të Tjerë (Aktive Afatgjata)		-	-
	6.Tituj tëTjere të Huadhënies		-	-
	Totali i Aktiveve Financiare (1-6)		-	-
2	Aktive Materiale:	9		
	1.Toka dhe Ndërtesa		1,465,046,954	1,418,189,098
	2.Impiante dhe Makineri		12,231,573	5,864,946
	3.Të Tjera Instalime dhe Pajisje		20,262,907	15,288,507
	4.Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces		1,138,532,712	123,069,385
	Totali i Aktiveve Materiale(1-4)		2,636,074,146	1,562,411,935
3	Aktive Biologjike			
4	Aktive Jo-Materiale:			
	1.Koncesione, Patenta, Licenca, Marka Tregtare		854,126	1,708,250
	2.Emri i Mirë		-	-
	3.Parapagime për Aktive Afatgjata Jo Materiale		-	-
	Totali i Aktiveve Jo-Materiale(1-3)		854,126	1,708,250
5	Aktive Tatimore të Shtyra	18		
	Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		2,636,928,272	1,564,120,185
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)		3,208,306,774	2,103,044,643

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR(BILANCI)-VAZHDIM
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
B	DETYRIME DHE KAPITALI			
I.1	Detyrime Afatshkurtera:	10		
	1.Titujt e Huamarrjes		-	-
	2.Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë		269,278,886	186,758,586
	3.Arkëtime në Avancë për Porosi		537,430	481,559
	4.Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)		69,875,535	81,883,848
	5.Dëftesa të Pagueshme		-	-
	6.Të Pagueshme ndaj Njesise Ekonomike Brenda Grupit		-	-
	7.Të Pagueshme ndaj Njesise Ekonomike Pjesëmarrje		-	-
	8.Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.		3,053,353	2,974,050
	9.Të Pagueshme për Detyrime Tatimore		1,671,645	466,698
	10.Të Tjera të Pagueshme		57,526,216	47,124,949
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (1-10)		401,943,065	319,689,690
	2 Të Pagueshme për Shpenzime të Konstatuara		-	-
	3 Të Ardhura të Shtyra(dhe Grantet)		8,067,592	8,067,592
	4 Provizionet		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		410,010,657	327,757,282
II.1	Detyrimet Afatgjata:	11		
	1.Titujt e Huamarrjes		-	-
	2.Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë		1,344,491,376	833,075,561
	3.Arkëtime në Avancë për Porosi		-	-
	4.Të Pagueshme për Aktivitet Shfrytëzuese(Furnitore)		-	-
	5.Dëftesa të Pagueshme		-	-
	6.Të Pagueshme Ndaj Njesise Ekonomike Brenda Grupit		-	-
	7.Të Pagueshme Ndaj Njesise Ekonomike Pjesëmarrje		-	-
	8.Të Tjera të Pagueshme		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatgjata(1-8)		1,344,491,376	833,075,561
	2 Të Pagueshme për Shpenzime të Konstatuara		-	-
	3 Të Ardhura të Shtyra		621,533,565	113,022,280
	4 Provizione(Për pensionet, etj)		-	-
	5 Detyrime Tatimore të Shtyra	18	4,889,608	2,935,922
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		1,970,914,549	949,033,763
	TOTALI I DETYRIMEVE (I+II)		2,380,925,206	1,276,791,045
III	Kapitali dhe Rezervat	12		
	1 Kapitali i Nënshkruar		876,860,000	883,085,000
	2 Primi i Lidhur me Kapitalin (-)		15,775,830	15,775,830
	3 Rezerva Rivlerësimi		100,378,379	100,378,379
	4 Rezerva të tjera		-	-
	1.Rezerva Ligjore		-	-
	2.Rezerva Statutore		-	-
	3.Rezerva të Tjera		-	-
	5 Fitimi i Pashpërndarë		(172,985,611)	(179,376,253)
	6 Fitimi (Humbja) e Vitit Financiar		7,352,970	6,390,642
	Totali i Kapitalit dhe Rezervave(III)		827,381,568	826,253,598
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT NETO (II+III)		3,208,306,774	2,103,044,643

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E PERFORMANCËS
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

**A.Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
(Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës)**

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1	Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit	13	228,841,256	220,892,184
2	Ndryshimi në Inventarin e Produkteve të gatshme dhe prodhimit në proc		-	-
3	Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar		4,179,685	1,190,575
4	Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit		27,395,498	16,767,612
5	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	14	(47,298,302)	(40,865,780)
	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		(18,498,126)	(20,981,969)
	Të Tjera Shpenzime		(28,800,176)	(19,883,811)
6	Shpenzime Personeli	15	(125,566,623)	(114,567,581)
	Paga dhe Shpërblime		(108,095,603)	(98,913,311)
	Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore		(17,471,020)	(15,654,270)
7	Zhvlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale	9	-	-
8	Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi	9	(59,047,874)	(52,121,036)
9	Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi	16	(13,123,215)	(25,656,325)
10	Të Ardhura të Tjera			
	Të Ardhura nga Aktiviteti Pjesëmarrës në Njësi të Tjera Ekon.		-	-
	Të Ardhura Nga Investimet dhe Huatë e Tjera		-	-
	Interesa të Arketueshem dhe të Ardhura të Tjera të Ngjashme		-	-
			-	-
11	Zhvlerësimi i Aktiveve dhe Investimeve Financiare (AASH)		(9,168,000)	
12	Shpenzime Financiare	17		
	Shpenzime Interesi dhe Shpenzime të Ngjashme		(10,164,529)	(10,042,077)
	Shpenzimet e Tjera Financiare		14,507,615	14,568,517
	Totali i Shpenzimeve Financiare		4,343,085	4,526,440
13	Pjesa e Fitimit/(Humbjes) nga Pjesëmarrja			
14	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit (11-15)		10,555,511	10,166,089
15	Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin	18	(3,202,541)	(3,775,447)
	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin		(1,248,855)	(2,224,911)
	Shpenzime(të ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë		(1,953,686)	(1,550,536)
	Pjesa e Tatim Fitimit të Pjesëmarrjeve		-	-
16	Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar (16-17)		7,352,970	6,390,642
17	Fitimi/(Humbja) Për:			
	Pronarët e Njesisë Ekonomike Mëmë			
	Interesat Jo-Kontrolluese			

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E PERFORMANCËS-VAZHDIM
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

B.Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Nr	Përshkrimi i Elementeve	Shënime	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1	Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar		7,352,970	6,390,642
2	Diferencat nga Përkthimi i Monedhës në Veprimtari të Huaja		-	-
3	Diferencat nga Rivleresimi i Aktiveve Afatgjata Materiale		-	-
4	Diferencat nga Rivleresimi i Aktiveve Financiare të Mbaj. Shitje		-	-
5	Pjesa e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse nga Pjesëmarrjet		-	-
6	Të Tjera të Ardhura Gjithëpërfshirëse për Vitin		-	25,312,076
7	Totali i të Ardhurave Gjithëpërfsh. për Vitin (2-6)		-	25,312,076
	Totali i të Ardhurave/(Humbjeve) Gjithëpërfshirëse (1+/-7)		7,352,970	31,702,718
	Pronarët e Njesise Mëmë		-	-
	Interesat Jo-Kontrolluese		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE (METODA INDIREKTE)
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shënimet	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
I	Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Shfrytëzimit			
	Fitimi/(Humbja) e Vitit Financiar		7,352,970	6,390,642
	Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		-	-
	Shpenzime Financiare Jo-Monetare		-	-
	Shpenzime për Tatimin mbi Fitimin Jo-Monetar		3,202,541	3,080,566
	Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi		59,047,874	52,121,036
	Zhvierësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale		-	-
	Fitimi nga Shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale (Fluksi i përfshire në akt. investuese)		9,676,696	46,133,408
	Ndryshimet në Aktivet dhe Detyrimet e Shfrytëzimit			
	Rritje/Rënie në të Drejtat e Arketueshme dhe të Tjera		(19,454,102)	(17,426,367)
	Rritje/Rënie në Inventarë		(8,793,271)	(2,699,218)
	Rritje/Rënie në Detyrimet e Pagueshme		320,157,616	27,071,006
	Rritje/Rënie në Detyrimet ndaj Punonjësve		79,303	(968,367)
	Mjete Monetare Neto nga Aktiv. e Shfrytëzimit		371,269,626	113,702,706
II	Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Investimit			
	Para Neto të Perdorura për Blerjen e Filialeve		-	-
	Para Neto të Arketuara nga Shitja e Filialeve		-	-
	Pagesa për Blerjen e Aktiveve Afatgjata Materiale		(872,253,771)	(320,100,046)
	Arkitime nga Shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		-	-
	Pagesa për Blerjen e Investimeve të Tjera		-	-
	Arkitime nga Shitja e Investimeve të Tjera		-	-
	Dividende të Arketuar		-	-
	Mjete Monetare Neto nga Aktiv. e Investimit		(872,253,771)	(320,100,046)
III	Fluksi i Mjeteve Monetare nga Aktiv. Financimit			
	Diference nga shtesa e Kapitalit Aksionar		(6,225,000)	219,171,000
	Diference rivlerësimi nga veprimet me kapitalin		-	25,312,076
	Hua të Arketuara		511,415,815	-
	Pagesa e kostove transaksionale (Hua dhe Kredi)		-	-
	Riblerje e Aksioneve të Veta		-	-
	Pagesa e Aksioneve të Perdorura si Kolateral		-	-
	Pagesa e Huave		-	(33,819,331)
	Pagese e Detyrimeve prej Qirase Financiare		-	-
	Interes i Paguar		-	-
	Dividende të Paguar		-	-
	Mjete monetare Neto nga Aktiv. e Financimit		505,190,815	210,663,745
IV	Rritje/Rënie Neto në Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet e Tyre		4,206,671	4,266,405
	Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet në Fillim të Periudhës		10,414,949	6,148,544
	Efekti i Lulatjeve të Kursit të Këmbimit		-	-
	Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet në Fund të Periudhës		14,621,620	10,414,949

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Kapitali nënshkruar	Fitimi i Lidhur me Kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të Tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
A	Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2015	663,914,000	15,775,830	75,066,303	-	-	-	(197,924,344)	18,548,091	575,379,880
	Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2015	663,914,000	15,775,830	75,066,303	-	-	-	(197,924,344)	18,548,091	575,379,880
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									
1	Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	-	6,390,642	6,390,642
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	25,312,076	-	-	-	-	-	25,312,076
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			25,312,076	-	-	-	-	6,390,642	31,702,718
2	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									
	Emetimi i kapitalit të nënshkruar (+ndryshimet brenda zerave)	219,171,000	-	-	-	-	-	18,548,091	(18,548,091)	219,171,000
	Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	219,171,000	-	-	-	-	-	18,548,091	(18,548,091)	219,171,000
B	Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2016	883,085,000	15,775,830	100,378,379	-	-	-	(179,376,253)	6,390,642	826,253,598
	Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2016	883,085,000	15,775,830	100,378,379	-	-	-	(179,376,253)	6,390,642	826,253,598
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									
1	Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	-	7,352,970	7,352,970
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:								7,352,970	7,352,970
2	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									
	Diference nga shtesa e kapitalit aksionar	(6,225,000)	-	-	-	-	-	6,390,642	(6,390,642)	(6,225,000)
	Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	(6,225,000)	-	-	-	-	-	6,390,642	(6,390,642)	(6,225,000)
C	Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2017	876,860,000	15,775,830	100,378,379	-	-	-	(172,985,611)	7,352,970	827,381,568

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "Ujësjiellësi Berat-Kuçovë" sh.a dhe janë nënshkruar nga:

ADMINISTRATORI

Refat HARIZI

HARTUESI

Enrieta MUHO

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)****1. Informacione të përgjithshme**

"Ujësja Berati-Kuçovë" sh.a është një shoqëri e krijuar nga bashkimi me përthithje i "Ujësja" sh.a Kuçovë nga "Ujësja" sh.a Berati bashkimi i realizuar me vendim të asamblesë së shoqërive në muajin Maj 2008 dhe gjendet e regjistruar në regjistrin tregtar(QKB), identifikuar me NIPT J62903166T. Ajo vepron në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë aktualisht është 876,830,000 lekë i ndarë në 876,830 aksione me vlerë nominale 1000 lekë për aksion. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë është prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm i popullatës dhe largimi i ujrave të ndotura

2. Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare(individuele) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

3. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elementë të metodave të tjera, dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vëndase, Lekë shqiptar ("lekë).

4. Politikave më të rëndësishme kontabël të zbatuara:**4.1 Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

4.2 Aktivitetet dhe detyrimet financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit(duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e përcaktuara në pikën 7 dhe 8 të SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të

për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuara. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivitet dhe detyrimet financiare shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në përcaktimet e SKK-2.

4.3 Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

4.4 Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

4.5 Aktivitet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktivi kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitet të hyrë dhe kostoja e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitet. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përgjashtime bëjnë aktivitet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi është llogaritur në baze të vendimit të Këshillit të Administrimit të datës 27 mars 2017 në të cilin është përcaktuar në amortizimi për të gjitha grupet e AAM-ve të llogaritet dhe njihet me metodën lineare, me norma të cilat

janë të përafërta me jetëgjatësinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndërtesa 2 %, në ndërtime speciale 2.5%, në stacione pompimi 5%, puse 4%, në instalime teknike makineri e paisje 10%, në mjete transporti 10% në paisje zyre 10% në paisje informatike 20%.

4.6 Aktivet afatgjata jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktivi nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndësa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

4.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëliti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

4.8 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si më poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përfaqësuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato linden

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2017 janë 1 euro=132.95 leke dhe 1 dollar=111.10 leke.

4.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor i shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime linden nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2017 është 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

Informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës

5. Mjete Monetare (likuiditete në arke, bankë etj.)

Gjendjet e mjeteve monetare në banke dhe arke, në fillim dhe fund të ushtrimit janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Monedha	Viti raportues 31.12.2017		Viti paraardhës 31.12.2016	
			Lekë	Valute	Lekë	Valute
1	Mjete monetare në arke	Lekë	142,679	-	69,933	-
2	Mjete monetare në bankë	Lekë/Euro/	14,478,941	-	10,345,016	-
3	Investime në tregje shumë likuide	Lekë	-	-	-	-
	Shuma		14,621,620	-	10,414,949	-

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave në fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

6. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arkëtueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël, deklarohen si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2017		Viti paraardhës 31.12.2016	
1	Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit(Kliente) vlera neto	427,720,266	396,289,121		
	Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit(Kliente) vlerësuar me kosto	436,888,266	396,289,121		
	Provizion për zhvlerësimin e klienteve	9,168,000	-		
2	Njesitë Ekonomike Brenda Grupit	-	-		
3	Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike	-	-		
4	Të Tjera (Debitore të tjerë)	47,096,339	57,486,069		
	Shteti-Tatim fitimi aktual	4,813,358	6,062,213		
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	-	744,294		
	Huadhenie e përkoshme	-	-		
	Te tjera (furnitore debitore dhe te tjera kërkesa)	42,282,981	50,679,562		
5	Kapital i Nënshkruar i Papaguar	-	-		
	Shuma	474,816,605	453,775,190		

Në postin e bilancit "Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Klientë)" është pasqyruar vlera neto e kërkesave ndaj klientëve ndërsa ne postin "Të tjera debitorë" janë paraqitur kërkesat ndaj shtetit për tatim fitimi derdhur tepër si dhe kërkesa të tjera debitorë.

Shoqëria, për klientët që kane detyrime të pa shlyera mbi 5 vjet, ka llogaritur provizion për zhvlerësim në masën 8% të vlerës së tyre gjithsej në shumën 9.168.000 lekë.

7. Inventari

Inventaret, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen, si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1	Lëndë e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	40,238,919	30,802,584
2	Inventar I imet	307,239	950,302
	Shuma	40,546,157	31,752,886

Si politike kontabël në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "mesatares se ponderuar". Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër përputhen me të dhenat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2017. Vlera e inventarëve e njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël është në shumën 21,860,178 lekë.

Perveç blerjeve gjate ushtrimit 2017 shoqëria ka marre inventare nga njesia e zbatimit të projektit "Infrastruktura Bashkiake II" reabilitimi i rrjetit të brendshem të furnizimit me uje dhe kanalizimet të cilat janë të pasqyruara edhe në situacionin e ketij investimi.

Shumat e inventareve në "Lëndë e Parë dhe Materiale të Konsumueshme", janë paraqitur me kostot mesatare të blerjes, e cila nga drejtimi, është vlerësuar si vlera më e ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur. Për rrjedhim nuk është parashikuar ndonjë shumë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme.

Shoqëria nuk ka inventare të dhënë si garanci apo që janë në ruajtje të palëve të tjera.

8. Shpenzime të Shtyra

Shpenzimet e shtyra, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen, si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
	Shpenzime të periudhave të ardhshme	41,394,120	42,981,433
	Shuma	41,394,120	42,981,433

Shpenzime të periudhave të ardhshme (për tu shpërndarë në disa ushtrime) përfaqësojnë shpenzimet për shërbimet konsulente për projektin e furnizimit me ujë Berat-Kuçovë shërbime eksperte për zbatimin e programeve të reduktimit të humbjeve të ujit. Shoqëria ka përcaktuar një plan amortizimi të këtyre shpenzimeve deri në vitin 2042 kur përfundon shlyerja e huasë afatgjatë (shih shenimin nr.11).

9. Aktivët Afatgjata Materiale(AAM-te)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivët afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

Nr	Gjendjet dhe levizjet	Toka/Terrene	Ndertesa	Impiante dhe makineri	Mjete transporti	Paisje zyre dhe informatike	Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2017	80,626,464	1,974,799,349	46,707,114	40,485,747	10,673,006	123,069,385	2,278,361,065
	Shtesat	-	103,557,579	11,413,966	4,419,074	3,803,828	1,018,338,209	1,141,532,656
	Pakësimet	-	9,295,636	5,721,030	9,886,939	1,373,705	2,874,682	29,152,192
	Kosto e AAM-ve 31.12.2017	80,626,464	2,069,061,292	52,400,050	35,017,662	13,103,129	1,138,532,713	3,388,741,630
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2017	-	637,236,714	40,842,169	27,321,164	8,549,082	-	713,949,129
	Amortizimi ushtrimit	-	50,474,723	4,751,782	1,801,709	1,165,535	-	58,193,749
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	3,070,636	5,425,474	9,886,939	1,092,447	-	19,475,496
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2017	-	684,640,801	40,168,477	19,235,934	8,622,170	-	752,667,383
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2017	-	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-	-
	Pakësimet	-	-	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2017	-	-	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2017	80,626,464	1,337,562,635	5,864,945	13,164,583	2,123,924	123,069,385	1,562,411,936
E	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2017	80,626,464	1,384,420,490	12,231,574	15,781,948	4,480,959	1,138,532,713	2,636,074,146

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto.

Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve është metoda lineare.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Drejtimi vlerëson se përgjithësisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

Ne aktive ne proces per shumen 1,018,338,209 leke eshte paraqitur nje pjese e aktivitetit te krijuar nga zbatimi i projektit "Infrastruktura Bashkiake II" reabilitimi i rrjetit te brendshem te furnizimit me uje dhe kanalizimet pasi nuk eshte bere akti perfundimtar i marrjes ne dorezim dhe kompletimi i dokumentacionit te plote te vleres se ketij investimi me vleren sherbimeve konsulence dhe zbatimi. Gjithashtu ne proces per shumen 120,194,503 leke eshte paraqitur edhe investimi i kryer me kredi tregtare per instalimin dhe vënien në funksionim të sistemit të matësave elektronik Wires për qytetin e Beratit dhe të Kuçovës dhe ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme së bashku me furnizimin e pjesëve software dhe hardware pasi edhe per kete investimi nuk eshte paraqitur situacioni perfundimtar dhe nuk eshte bere akti i marrjes ne dorezim.

10. Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afatshkurtëra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	269,278,886	186,758,586
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	537,430	481,559
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	69,875,535	81,883,848
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.	3,053,353	2,974,050
	Paga dhe shpërblime	92,108	54,281
	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,961,245	2,919,769
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore	1,671,645	466,698
	Shteti-Tatim mbi fitimin	-	-
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	1,167,755	-
	Tatim mbi të ardhurat personale	469,740	457,698
	Tatimi ne burim	34,150	9,000
10	Të Tjera të Pagueshme	57,526,216	47,124,949
	Shuma	401,943,065	319,689,690

Në postin e bilancit "Detyrimet ndaj institucioneve të kredisë" janë paraqitur interesat, penalitetet, komisionet e angazhimit të papaguara si dhe këstet e kredisë që duhet të paguhet brenda 12 muajve të ardhshëm (viti 2018). (Shih shënimin nr.11 në të cilin janë trajtuar kreditë e marra).

"Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitorë)" pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventarët kontabël dhe shuma e llogarise sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi ka gjykuar se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuar realisht.

"Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoqërore e shëndetsore" paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetsore të muajit dhjetor 2017.

"Të Pagueshme për Detyrime Tatimore" përbëhet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi në burim i muajit të fundit që do të paguhet në muajin janar 2018.

11. Detyrimet Afatgjata

Detyrimet Afatgjata në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	1,344,491,376	833,075,561
	Kredi KFW(Projekti furnizimi me uje shqiperia e mesme)	885,664,329	764,968,315
	Kredi F.M.O. shpk	33,962,043	68,107,247
	Kredi KFW (Infrastruktura bashkiake 1)	624,865,004	
	Shuma	1,344,491,376	833,075,561

Më datë 15.01.2003 midis Kreditantalt fur Wiederaufbau, Frankfurt mbi Main (KFW), Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave Tiranë dhe Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit, Shoqëria "Ujësjiellësi Berat-Kuçovë" është lidhur marrëveshja e kredisë së projektit "Furnizimi me Ujë Shqipëria e Mesme" Komponenti Berat Kuçovë. Shuma e huasë është 6.646.794.46 Euro. Kjo hua u përdor për të financuar nxjerrjen, transmetimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm për zonen e Beratit dhe të Kuçovës. Sipas marrëveshjes së kredisë nënhuamarrësi shoqëria "Ujësjiellësi Berat-Kuçovë" sh.a do të paguajë Ministrisë së Financave një interes prej 0.75 % në vit mbi të gjitha fondet e tërhequra dhe një tarifë (komision) angazhimi 0.25% në vit për pjesën e pa disbursuar me dy këste më 30 Qershor dhe 30 Dhjetor të çdo viti. Ky interes llogaritet mbi teprcen ditore të kredisë. Shlyerja e huasë do të bëhet me dy këste fikse 110.000 Eur për çdo këst, më 30 Qershor dhe 30 Dhjetor, duke filluar në datën 30 Dhjetor 2012 deri më datën 30 Qershor të vitit 2042. Ministria e Financave nga ana e saj do t'ia paguajë këto këste KFW-së. Në rast mospagese të detyrimeve në afatet e përcaktuara do të aplikohen interesvonesa.

Ky projekt ka perfunduar dhe shuma e huasë së disbursuar sipas të dhënave të Ministrisë së Financave është 6.587.309.73 Euro ndërsa sipas të dhënave të shoqërisë huaja e përdorur është 6.435.590.38 Euro ose 902.269.771 lekë. Diferenca prej 151,719,35 Euro ose 20,171,088 leke janë shërbime konsulence që i perkasin edhe shoqërive të Ujësjiellës Kanalizimeve Lushnje e Pogradec. Në këto kushte këtë diferencë shoqëria e ka kontabilizuar në pasiv të bilancit në zërin hua nga bankat dhe në aktiv të bilancit si kërkesë për tu sqaruar.

Shlyerja e kështit të parë të kredisë në shumën prej 110.000 Euro duhet të fillonte më datë 30.12.2012.

Nga data 30.12.2012 deri më 31.12.2017 sipas planit të shlyerjes duhet të shlyeshin 1,210,000 Euro. Deri më 31.12.2017 janë shlyer 360.000 Euro pricipal dhe 71,697,69 Euro interes. Më datë 31.12.2017 ka mbetur pa u shlyer në afat 850,000 Euro kredi (pricipal), 426,134.64 Euro interes e komisione dhe 31,947 Euro penalitete. Shuma e interesave, komisioneve të angazhimit, penaliteteve, kësteve të prapambetura dhe kësteve që duhet të shlyen gjatë vitit 2018, gjithsej 1,528,081.64 Euro ose 203,158,393 lekë, janë klasifikuar dhe janë paraqitur në bilanc si detyrime afatshkurtëra.

Shuma e kredisë, interesit, komisionit të angazhimit dhe e penaliteteve me 31.12.2017 të huasë ndaj KFW per kete projekt është 6,685,390.91 Euro ose 888,822,722 lekë.

Gjithashtu me KFW eshte lidhur aktmarreveshja per programin "Infrastruktura Bashkiake II" ne shumen 9,306,000 Euro nga e cila 4,700.000 jane hua dhe pjesa tjeter eshte grand. Kredia eshte me afat 30 vjet me shlyerje me keste 6 mujore më 30 Qershor dhe 30 Dhjetor të çdo viti me periudhe pa pagese Interesi 10 vjet. Sipas marreveshjes se nenhuase te lidhur me date 30.05.2012 me Ministrine e Financave kjo kredi do te filloje te shlyet me date 30 Qershor 2022 dhe do te mbaroje me date 30 Dhjetor 2051. Ky program eshte perdorur per permiresimin e rrjetit të brëndshëm të furnizimit me uje dhe i kanalizimeve. Shuma e përdorur është 8,523,586 Euro nga e cila 4,700,000 Euro është kredi dhe 3,823,586 Euro është grand.

Më datë 21 Tetor 2013 shoqëria ka lidhur një marrëveshje kredie tregtare me shoqërinë "F.M.O" sh.p.k. me NIPT:L02324003H dhe shoqërinë "INTERGRATED TECHNOLOGY SERVICES" sh.p.k me NIPT:L02302032C marrëveshje e garantuar me letër garanci bankare nga VENETO BANKA sh.a. për shumën 950.000 Euro për instalimin dhe vënien në funksionim të sistemit të matësive elektronik Wirles për qytetin e Beratit dhe të Kuçovës dhe ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme së bashku me furnizimin e pjesëve software dhe hardware me interes 4.5% në vit me afat kthimi me këste mujore në 72 muaj. Komisioni për lëshimin e letër Garanci kredie VENETO BANKA sh.a. është 2.4% në vit mbi shumën totale plus kostot e transfertës Swit. Shuma e kredisë (pricipal) që do të shlyet në vitin 2018 për 497,334 Eur ose 66,120,493 lekë është klasifikuar dhe paraqitur në bilanc si hua afatshkurtër në postin "Detyrime ndaj institucioneve të kredisë". Shuma e kredisë dhe interesave të kësaj kredie më datë 31.12.2017 është 752,783 Euro ose 100,082,536 lekë.

12. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, është i njëjtë me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në Qendrën Kombëtare të Biznesit deri më 31.12.2017.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 876,860,000 lekë i ndarë në 876,860 aksione me vlerë nominale 1000 lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët:

- Aksionari Bashkia Berat, zotëron 572,787 aksione, me vlerë të përgjithëshme 572,787,000 lekë, e cila përbën 65,32% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Aksionari Bashkia Kuçovë, zotëron 304,073 aksione, me vlerë të përgjithëshme 304,073,000 lekë, e cila përbën 34,68% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

13. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017, paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1	Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit:		
	Shitje e produkteve te gatëshme dhe nënprodukteve	196,912,992	191,096,066
	Shitja e punimeve dhe shërbimeve	31,928,264	29,796,118
	Shitja e mallrave	-	-
	Të ardhura nga shitje të tjera	16,895,498	16,767,612
	Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit	245,736,754	237,659,796
2	Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar	4,179,685	1,190,575
3	Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit	10,500,000	-
	Të ardhura nga Shitja e Aktiveve Afatgjata	-	-
	Të ardhura nga grantet per aktive afatgjata	-	-
	Të ardhura nga grante te tjera	10,500,000	-
	Të ardhura të tjera()	-	-
	Shuma	260,416,439	238,850,371

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. (Njohja dhe vlerësimi janë bazuar në SKK 8 të përmirësuar).

14. Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017, paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1	Ndryshime ne inventarin e P.te gatshme dhe P.Proces	-	-
2	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	47,298,302	40,865,780
	Lënda e Parë dhe Materiale	18,498,126	18,116,798
	Karburant	3,362,052	2,865,171
	Energji elektrike	25,438,124	19,883,811
		-	-
3	Te tjera shpenzime	-	-
	Shuma	47,298,302	40,865,780

15. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para dhe shpërblimet.

Numri mesatar i punonjësve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë:

Nr	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1 Shpenzime Personeli		
Paga dhe Shpërblime	107,892,234	91,663,247
Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	17,471,020	15,654,270
Të tjera	203,369	7,250,064
Shuma	125,566,623	114,567,581
2 Numri mesatar vjetor i të punësuarve	248	232

16. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Nr	Emertimi	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
I Të Tjera Shpenzime			
1 Shërbime nga të tretët dhe shpenzime të tjera		6,310,991	4,996,610
Trajtime të përgjithëshme(nga të trete)		577,633	448,119
Qera		270,000	450,000
Mimbajtje dhe riparime		324,653	665,187
Sigurime		320,427	526,477
Publicitet, reklama		20,500	-
Trasferime, udhëtime, dieta		421,314	216,120
Shpenzime postare dhe telekomunikimi		1,159,967	962,502
Shpenzime transporti		-	-
Shpenzime për shërbimet bankare		109,265	151,478
Të tjera		3,107,232	1,576,727
3 Tatime dhe taksa(Ilog.63)		3,372,480	3,998,870
Taksa dhe tarifa vendore		263,200	152,200
Taksa të regjistrimit		-	-
Tatime të tjera		3,109,280	3,846,670
4 Shpenzime të tjera jo korente(Ilog.67)		2,016,349	1,587,313
Vlera kontabël e AA të shitura		429,036	-
Te tjera		1,587,313	1,587,313
5 Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi Llog.65,68)		1,423,395	15,073,532
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime		-	-
Gjoha dëmshpërblime		1,423,395	160,701
Provizione		-	-
Te tjera		-	69,979
Kamatvonesa për moslikuidimin në kohë të energjisë elektrike		-	14,842,852
Shuma		13,123,215	25,656,325

17. Të ardhura të tjera. Shpenzimet financiare

Të ardhura të tjera dhe Shpenzimet financiare janë paraqitur sipas kërkesave të standarteve dhe përbëhen si vijon:

Nr	Viti raportues 31.12.2017	Viti paraardhës 31.12.2016
1 Te ardhura te tjera	15,824,549	17,317,611
Interesa te arketuara	2,618	6,022
Te ardhura te tjera financiare	1,314,316	2,670,871
Fitim nga kembimet dhe perkthimet valutore	14,507,615	14,640,717
2 Shpenzime financiare	11,481,464	12,791,171
Shpenzime per interesa	11,481,464	12,718,971
Shpenzime te tjera	-	72,200
Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	-	-
Shuma	4,343,085	4,526,440

18. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Në vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shpenzime tatimore të shtyra.

Nr.	Elementet e tatimit mbi fitimin	Viti raportues 2,017		Viti paraardhës 2,016	
		Shuma	Tatim fitimi	Shuma	Tatim fitimi
I	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin				
1	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit	10,555,511	1,583,327	10,166,089	1,524,913
2	Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-) Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e kontrollit dhe të tjera(rimarrje provizionesh,gjobash etj))(-)	-	-	-	-
3	Shpenzime te panjohura tatimore(+) Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor(+) Gjoha,penalitet,demshperblime(+) Amortizim mbi normat fiskale(+) Provizione per rreziqe e shpenzime(+) Të tjera	10,794,764 - 1,423,395 - 9,168,000 203,369	1,619,215 - 213,509 - 1,375,200 30,505	15,003,553 - 15,003,553 - - -	2,250,533 - 2,250,533 - - -
4	Diferenca pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus njohjet për qëllimet e raportimit(-) Amortizimi i përsheptuar tatimor(-) Të tjera(-)	(13,024,574) (13,024,574) -	(1,953,686) (1,953,686) -	(10,336,903) (10,336,903) -	(1,550,535) (1,550,535) -
5	Zbritja e humbjes tatimore(-)	-	-	-	-
	Fitimi i Tatueshëm dhe shpenzime te tatim fitimit aktual	8,325,701	1,248,855	14,832,739	2,224,911
II	Shpenzim(të ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë(+/-)	x	1,953,686	x	1,550,535
III	Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin(I+II)	x	3,202,541	x	3,775,447

Për llogaritjen e shpenzimeve për Tatimin mbi Fitimin shoqëria ka zbatuar SKK 11 të përmirësuar.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15%. Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kërkesat e legjislacionit fiskal.

Meqëse për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale shoqëria përdor metodën lineare midis shpenzimit tatimor të lejuar nga legjislacioni fiskal dhe shpenzimit të amortizimit të përdoruar nga shoqëria për efekt raportimi ka një diferencë prej 13,024,574 lekë që përfaqëson amortizimin tatimor të përsheptuar. Kjo diferencë është marë në konsideratë për llogaritjen e shpenzimeve për tatimin mbi fitimin. Për këtë diferencë është llogaritur tatim fitim i shtyrë në shumën 1,953,686 lekë.

19. Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Anjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

20. Shpjegime mbi palët e lidhura

Me marrjen në konsideratë të çdo transaksioni dhe marrëdhënie të mundëshme, jo thjesht formën ligjore të tyre në datë 31 dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

21. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese të deklaruara në pasqyrat financiare 2016 janë të njëjta me ato të prezantuara në vitin aktual 2017.